



BASHKIA KURBIN

**PAKETA FISKALE
Bashkia e KURBINIT
2021**

“Për një vetëqeverisje efikase dhe efçente, që synon të realizojë funksionet dhe përgjegjësitë e saj administrative në dobi të komunitetit”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN

Nr. _____ Prot

Laç më ___/___/2021

VENDIMI

Nr 152 Datë 14/ 12/ 2020

**PËR
MIRATIMIN E NIVELIT TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, LEHTËSIRAT
FISKALE, STRUKTURAT E VJELJES SË TYRE SI DHE VENDOSJES SË
PENALITETEVE NDAJ KUNDRAVAJTËSVE**

Mbështetur në:

- Ligjin nr.139/2015 dt.17.12.2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, neni 9, pika1/1.3, gërma ”b”, neni 35, pika 4, neni 54, gërma ”f”;

Ligjin nr.9632 dt.30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, neni 5, gërma ”b”, ”c” dhe ”ç”, neni 7, neni 9 etj., Ligjin nr.9920 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr.68/2017 ”Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Ligjin nr.115/2014 ” Për Ndarjen Administrative Territoriale të Njësiteve të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr.9975 ” Për Taksat Kombëtare ”, i ndryshuar, Ligjin nr.9723 ”Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, Ligjin nr. 107/2014. “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar; Ligjin nr.10465 datë 29.09.2011 ” Për Shërbimin Veteriner në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr.8378 datë 22.07.1998 ” Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr.10081. datë 23.02.2009. ”Per licensat, autorizimet dhe lejet ne Republikën e Shqiperise” i

ndryshuar, Ligjin nr.10304. datë 15.07.2010. "Per sektorin minerar ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, Ligjin nr.8450. date 24.02.1999. "Për perpunimin, transportin dhe tregtimin e naftes, gazit dhe nenprodukteve te tyre" i ndryshuar me ligjin nr.970 date 02.12.2015, Ligjin nr.10279. date 20.05.2010. "Për kundravajtjet administrative", Ligjin nr.152/2015. date 21.12.2015. "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi", Ligjin nr.8438. dt.28.12.1998. "Per tatimin mbi te ardhurave" i ndryshuar, VKM nr.132 datë 07.03.2018 " Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme Ndërtesa, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënat për përcaktimin e bazës së taksës , si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës ", Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 783. datë 10.11.2011. "Për procedurat e ndarjes se te ardhurave te takses vjetore te mjeteve te perdorura me njesite e qeverisjes vendore" i ndryshuar, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 7. datë 04.12.2012. "Për percaktimin e procedurave dhe te dokumentacionit te nevojshem per arketimin e takses se rentes minerare" i ndryshuar, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 970. datë 02.12.2015. "Për percaktimin e procedurave dhe te kushteve per dhenien e licensave per tregtimin e naftes bruto dhe nenprodukteve te saj"i ndryshuar me VKM nr.344 dt.19.04.2017, Vendim i Këshillit të Ministrave nr.391,date 21.06.2006 "Per percaktimin e tarifave ne sektorin e pyjeve dhe kullotave" i ndryshuar me V.K.M nr.1064,date 22.12.2010. ligjit nr.9385 datë 04/05/2005 "Për pyjet dhe Shërbimin Pyjor", V.K.M nr.433,date 08.06.2016, "Për transferiminnë pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive",V.K.M. nr.632, datë 11/06/2009, "Për miratimin e tarifave te përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje"; Vendim i Këshillit të Ministrave nr.54. date 05.02.2014 "Per percaktimin e kriterëve, dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore" i ndryshuar me V.K.M nr.992,date 09.12.2015, i ndryshuar me VKM nr. 672 datë 02.09.2020 ; Udhëzimin nr.5627 datë 18.11.2016 " Për përcaktimin e kriterëve rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e liçencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit", i ndryshuar; Udhëzim i Ministrit të Financave nr.1, datë 12.1.2007 "Për përcaktimin e veprimtarive që trajtohen si veprimtari, tregtare apo shërbimi, ambulante si

dhe procedurat e regjistrimit të tyre në organin tatimor”; Udhëzim i MF nr.32. datë.31.12.2013. . “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e Biznesit të Vogël” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrit të Financave, nr.26, datë 04.09.2008 “Për taksat kombëtare” i ndryshuar; Udhëzim i perbashket (Ministri i Financave dhe Ministri drejtesise) nr.655/1.dt.06.02.2007. “ Per percaktimin e uniformitetit te standarteve procedurale dhe te raportimit te sistemit te taksës vendore”; Udhëzimit nr.15 date 24.07.2007. “Per kriteret dhe procedurat e lëshimit te liçensave,autorizimeve,dhe çertifikatave per ushtrimin e veprimtarise ne transportin rrugor” i ndryshuar; legjislacionit të aplikueshëm në fuqi , akteve nënligjore të miratuara në bazë dhe për zbatim të ligjeve të sipërcituara. Këshilli i Bashkisë Kurbin pasi shqyrtoi projekt-paketën e propozuar nga Kryetaria e Bashkisë me miratim të anëtarëve të Këshillit Bashkiak:

VENDOSI

Të miratojë nivelin e taksave dhe tarifave vendore , lehtësirat fiskale, strukturat përgjegjëse për vjeljen e tyre si më poshtë :

- I. Të bëjë ndarjen administrative territoriale të Bashkisë Kurbin, për efekt të diferencimit në ofrimin e cilësisë së shërbimeve , me qëllim bashkërendimin e tyre me nivelin e aplikimit të taksave dhe tarifave vendore , në zonat si më poshtë:
 - a. Nj/A Laç
 - b. Nj/A Mamurras
 - c. Nj/A Milot
 - d. NJ/A Fushë-Kuqe
- II. Të miratojë për të gjithë kategoritë e taksapaguesve dhe përfituesve të shërbimeve publike, të ofruara në territorin brenda juridksionit të Bashkisë Kurbin , nivelin e taksave dhe tarifave vendore, afatet e pagesës, përjashtimet e lehtësirat fiskale për çdo zë, sipas kategorive përfituese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e tyre, të drejtën e ankimimit për çdo vlerësim, arsyen e vendosjes së penalteteve , gjobave, për kundravajtjet e shkaktuara nga tatimpaguesi, nivelin e tyre për çdo kundravajtje si dhe strukturat e ngarkuara për vendosjen e vjeljen e tyre, si më poshtë vijon:

Kapitulli I : Taksat Vendore

Në zërin ‘Taksa Vendore’ , konform ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 ‘Për Sistemin e Taksave Vendore’, i ndryshuar përfshin : lloji, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë, si më poshtë :

1. Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin për Biznesin e Vogël
2. Taksa mbi Pasurinë e Paluajtshme
 - a. Taksa mbi Ndërtesat
 - b. Taksa mbi Tokën Bujqësore
 - c. Taksa mbi Trruallin
3. Taksa e fjetjes në hotel
4. Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja
5. Taksa mbi Kalimin e të Drejtës së Pronësisë për Pasuritë e Paluajtshme
6. Taksa e tabelës
7. Taksa të përkohshme

I.1 Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8 000 000 (tetë milionë) lekë, u nënshtrohet detyrimeve të parashikuara në këtë kre.

Të ardhurat gjithsej nga veprimtaria e biznesit të vogël nënkuptojnë çdo lloj të ardhure, të realizuar gjatë periudhës tatimore dhe përfshijnë, pa u kufizuar vetëm në to: të ardhurat e realizuara nga furnizimi i mallrave dhe shërbimeve, të ardhurat nga pjesëmarrjet, të ardhurat nga interesat, të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurisë së luajtshme e të paluajtshme.

Shkalla tatimore

Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është 0 (zero).

Nr.	Tatimpaguesit sipas nivelit të xhiros	Njësia	Shkalla tatimore
1	Me qarkullim vjetor nga 0-8 milion lekë	Lekë/vit	0 %

Struktura përgjegjëse :

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore është e ngarkuar me vlerësimin dhe kontrollin e tatimpaguesve, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

Administrata rajonale tatimore krijon një regjistër të veçantë mbi biznesin e vogël, në bazë të të dhënave që merr nga bashkitë. Ky regjistër do të përditësohet me hapjen e biznesve të reja.

❖ *Neni 18 - Transferimi i të ardhurave në llogaritë e njësive të qeverisjes vendore dhe në buxhetin e shtetit dhe komisioni i agjentit tatimor;*

❖ *Neni 19 - Bashkëpunimi*

(Shfuqizuar me efekt nga 1 Janari 2021 me Ligj Nr. 122/2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 197, datë 12.11.2020)

I.2 Taksa mbi pasurinë e paluajtshme.

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë të pasurive ose përdorues të saj, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe.

Detyrimin për taksën mbi pasuritë e paluajtshme e ka sipas rastit, pronari ose bashkëpronari sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshmen për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokument pronësie.

Taksa mbi pasurinë e paluajtshme përbëhet nga:

I.2.1 Taksa mbi ndërtesën.

I.2.2 Taksa mbi tokën bujqësore.

I.2.3 Taksa mbi truallin.

Taksa llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet vetëm për periudhën e të drejtës së pronësisë ose përdorimit.

Në rastet e mungesës së dokumentacionit të pronësisë (ndërtesë, truall) përdoruesi i pasurisë ka të drejtë të bëjë një vetëdeklarim të sipërfaqes së pronës pranë Bashkisë Kurbin. Bashkia nëpërmjet komisionit të ngritur (inspektorët e Drejtorisë së Planifikimit të të Ardhurave Vendore e të tjerë) mund të vlerësojnë sipërfaqen e taksueshme me proces-verbal.

I.2.1 Taksa mbi ndërtesat:

- Baza e taksës

Baza e taksës mbi ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat, e shumëzuar me çmimin e shitjes sipas zonave.

Sipërfaqja në pronësi të taksapaguesit përcaktohet sipas dokumenteve (Çertifikatë e Pronësisë, Vendimi i Komisionit të Kthimit të Pronave, Vendimi i Privatizimit etj) konform legjislacionit në fuqi që e vërtetojnë këtë pronësi ose sipas kontratës së përdorimit. Në mungesë të këtyre dokumentave, paraqitet deklaratë (*deklarata ka vlefshmëri 1 (një) vjeçare*) që vërteton përdorimin e pasurisë së paluajtshme nga personi për qëllim fitimi ose jo. Deri në paraqitjen e

dokumentacionit të pronësisë ose vetëdeklarimit të sipërfaqes së ndërtesës, si një detyrim për çdo taksapagues, taksa llogaritet sipas sipërfaqes së nënshkruar në dokumentat e lartpërmendur, në rast të kundërt detyrimi i taksës së ndërtesës për banim të taksapaguesve në çdo Njësi Administrative, vlera u llogaritet për një sipërfaqe 100 m² objekt.

Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave. Këshilli i Ministrave, në bazë të vjetërsisë së ndërtesës, mund të specifikojë nënkategori përkatëse. Sqarojmë se, baza e taksës së ndërtesës për Njësitë Kurbin, sipas Aneksit nr.1 të ligjit nr.9632, datë.30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, jepet në vlerat mesatare të shitblerjes së banesave, sipas qyteteve: Laç është në vlerën 42,500 lek/m², Mamurras është në vlerën 42,500 lek/m², ndërsa për Milotin vlera 34,000 lek/m² dhe për Fushë-Kuqen do të referohemi Njësisë më të afërt, në këtë rast i referohemi Njësisë Milot, pikërisht në vlerën 34,000 lek/m²

Shkalla e taksës

Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë:

- a) 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- b) 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
- c) 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Informacioni lidhur me taksën mbi ndërtesën Këshilli i Ministrave përcakton rregulla në lidhje me:

- a) natyrën dhe prioritetin e informacionit që do të përdoret në lidhje me përcaktimin e bazës së taksës mbi ndërtesat, në raste mospërputhjes të informacionit të marrë nga burime të ndryshme;
- b) prioritetin e të dhënave që do të përdoren në lidhje me vlerën e tatueshme.

Shembull i përlllogaritjes së taksës mbi ndërtesën;

Subjekt (banesë) Laç – $100\text{m}^2 > 42,500 \times 0,05\% = 21.3 \times 100 \text{ m}^2 = 2,130 \text{ lek/vit}$

Subjekt (njësi) Laç – $100\text{m}^2 > 42,500 \times 0.2\% = 85 \times 100 \text{ m}^2 = 8,500 \text{ lek/vit}$

Nevojitet që Njësitë Administrative Vendore të marrin të gjitha masat për të garantuar administrimin e procesit të vlerësimit të bazës së taksës, llogaritjen e taksës dhe mbledhjen e saj, sipas dispozitave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore të sipër përmendura.

Tabela 1. Taksa e ndërtesës sipas kategorive të njësive Kurbin

TAKSA MBI NDËRTESEN SIPAS KATEGORIVE TË NJËSIVE KURBIN					
Nr	Klasifikimi sipas Njësia Administrative	LAÇ	MAMURRAS	MILOT	FUSHË-KUQE
	Njësia matëse	lek/m² në vit	lek/m² në vit qytet - fshat	lek/m² në vit	lek/m² në vit
1	Ndërtes Banimi	21	21-17	17	17
2	Ndërtes subjekti privat (Njësi)	100	100	80	80
3	Ndërtes me leje ndërtimi të pa realizuar në afat (Banes,) 30%	30	30	24	24
4	Ndërtes me leje ndërtimi të pa realizuar në afat (Njësi) 30%	30	30	24	24
5	Ndërtes parkimi të mbuluar dhe bodrume 70 % e sip. baneses	70	70	56	56
6	Ndërtes për veprimtari industriale 50 % e takse	50	50	40	40
7	Ndërtes përdoren për	30	30	24	24

	bujqësi dhe blegtori apo veprimtari mbështetëse 30% e sip. baneses				
8	Ndërtes në njësitë administrative jashtë qytetit përkatës 35% e takses	35	35	28	28
9	Ndërtesat e privatizuara me ligjin nr. 7652, vetëm në rastin e shitjes së pare 70% e sip. baneses	15	15	12	12

-Çmimi mesatar për m² të sipërfaqes së ndërtimit për ndërtesat që nuk shërbejnë për banim klasifikohen:

a) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari tregtimi dhe shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori do të përfshihen edhe ndërtesa tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhim, tregtim ose/edhe shërbime, shitje me pakicë.

b) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi **për parkim të mbuluar dhe bodrume** është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas Njësive Administrative.

c) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi **për parkim të hapur** është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas Njësive Administrative.

ç) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara **për veprimtari industriale**, si: prodhim, përpunim ose magazinim të mallrave industriale, duke përfshirë fabrikat, depot, magazinat dhe objektet e tjera të ngjashme, është 50 (pesëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse sipas Njësive Administrative.

d) Çmimi për metër katror **sipërfaqe ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori apo veprimtari mbështetëse**, si grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe

blegtorale është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, me përjashtim të përpunimit ushqimor, sipas Njësive Administrative.

dh)Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për banim në njësitë administrative jashtë qytetit përkatës, të cilat iu bashkuan njësive të vetëqeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 115/2014, reduktohet deri në 35 (tridhjetë e pesë) për qind, krahasuar me çmimin e zonës më të afërt, përjashtuar zonat rezidenciale.

e) Për **ndërtesat e privatizuara** me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, të ndryshuar, çmimi për metër katror është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit sipas zonave të tabelës, **vetëm në rastin e shitjes së pare**, sipas Njësive Administrative.

Taksën mbi ndërtesat (banesë, njësi) llogaritet sipas vlerës së ndërtesës, në mungesës të dokumentit të pronësisë apo përdorimit të saj, ose të mosdeklarimi të sipërfaqes së ndërtesës, vlera e saj do të konsiderohet sipërfaqe 100 (njëqind) meter katror për taksim, siç e parashikon ligji nr.9632 datë 30.10.2006 i ndryshuar.

- **Përgjegjësitë e Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore**

Njësia e vetëqeverisjes vendore është autoriteti përgjegjës për administrimin e taksës mbi ndërtesat nën juridiksionin e saj, përmes ushtrimit të funksioneve të mëposhtme:

- a) mbledhjen dhe menaxhimin e informacioneve mbi ndërtesën për qëllime fiskale;
- b) përditësimin e të dhënave të regjistrit qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale);
- c) mbledhjen me forcë të detyrimeve të taksës mbi ndërtesën;
- ç) korrigjimin e të dhënave në lidhje me llogaritjen e taksës, në rastet e saktësimit të informacionit për sipërfaqen, vendndodhjen zonale, çmimet e tregut etj.;
- d) shqyrtimin e ankimit administrativ të taksapaguesve.

- Të ardhurat e mbledhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme derdhen për llogari të buxhetit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, dhe përdoren në përputhje me ligjin “Për financat e vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

- **Mënyra e pagesës**

Për banesat private vjelja e taksës së ndërtesës të bëhet pranë **Njësi Administrative Vendore** për të garantuar administrimin e procesit të vlerësimit të bazës së taksës, llogaritjen e taksës dhe mbledhjen e saj në nivel maksimal, e pasqyruar kjo në regjistër përkatës.

Nivelet treguese të taksës mbi ndërtesën që shërbejnë për banim, si dhe kategoritë dhe nënkategoritë sipas qëllimit të përdorimit të ndërtesës, zbatohen taksat për m² si më poshtë vijon.

Në mbështetje të ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 i ndryshuar me vendimin nr.132, date 07.03.2018 pika 3, propozojmë një rritje të nivelit të taksës deri në masën 18% për taksën mbi ndërtesën për tatimpaguesit e subjekteve private (bizneset), që janë nën juridiksion të Njësi Administrative Kurbin, për të katër Njësitë Administrative: të Laçit, Mamurrasit, Milotit dhe Fushë-Kuqes. Për subjektet e banimit në fshatrat nën juridiksion të Njësisë Administrative të Mamurrasit, propozojmë uljen në masën 24 % të nivelit të taksës mbi ndërtesën, e cila bëhet e barabartë me nivelin e taksës për banesën, me Njësitë Milot dhe Fushë-Kuqe pikërisht në vlerën 17 lekë/m² në vit, pasqyruar kjo sipas tabelës më lart.

- **Afatet e pagesës së taksës së ndërtesës**

Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor. Subjektet private (familjarët) taksën për banesën duhet ta shlyejnë deri me datën 30.12.2021. Për të gjitha kategoritë e subjekteve që ushtrojnë aktivitet privat, ky detyrim paguhet me një këst vjetor. Afati i pagesës është data 30 Shtator 2021.

- **Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:**

- a) pronat e shtetit dhe të njësi të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- ç) banesat sociale në pronësi të bashkive;
- d) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;

- dh) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;**
- e) strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “*brand name*”;
- ë) ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të pa aftë për punë;
- f) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- g) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.

-Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës së ndërtesës:

Përgjegjësit për vjeljen e taksës mbi ndërtesën (banesë) të subjekteve private janë:

- a. Për vjeljen e taksës mbi ndërtesat, për kategorinë “Biznes”, struktura përgjegjëse është Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave Vendore, e cila e kryen llogaritjen në bazë të sipërfaqes dhe vlerës së taksës dhe kategorive në tabekën e cituar më lart. Detyrimi për taksën e ndërtesës është vjetor (jo me këste).
- b. Për vjeljen e taksës mbi ndërtesat e banimit për kategorinë “Familjarë” , struktura përgjegjëse mbeten të gjitha Njesitë Administrative në bashkëpunim për të rakorduar të ardhurat me Drejtorinë e Planifikimit të të Ardhurave Vendore në Bashkinë Kurbin.

Zyrat e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme nuk bëjnë regjistrimin apo çregjistrimin e pasurisë së paluajtshme, ndërtesë apo tokë bujqësore, nëse dokumentacioni i vërtetimit tëpronësisë nuk shoqërohet edhe me vërtetimin e bashkisë, i cili konfirmon pagesën e taksave.

I.2.2 Taksa mbi tokën bujqësore

“Tokë Bujqësore” është toka e përcaktuar si e tille në regjistrin e zyrave të regjistrimit të pasurisë.

Kjo taksë zbatohet sipas ligjit nr.9632 dt.30/10/2006 , “Aneksi nr.2 i tij (vlera e taksës në lek / hektar në vit) . Klasifikimi sipas kategorive të tokës bujqësore bëhet nga strukturat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit . Taksa e tokës bujqësore vazhdon me uljen prej **30 %** të nivelit të taksës për çdo kategori të tokës bujqësore të vendosur me Vendim Këshilli Bashkiak, kjo bazuar në kompetencat që i jep Ligji nr. 9632. datë.30/10/2006, i ndryshuar, si dhe propozimit të Drejtorisë së Mjedisit pranë Bashkisë.

Baza e taksës: është sipërfaqja e Tokën Bujqësore në hektar, në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës përcaktohet mbi bazën e dokumentave të pronësisë, formularit nr.6, aktit të pronësisë, çertifikatës së regjistrimit të tokës. Në rastin e mungesës së dokumentave, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes pranë Bashkisë ku ndodhet toka.

Niveli i taksës mbi tokën bujqësore paraqitet si më poshtë:

-Njësia Laç , Mamurras, Milot dhe Fushë-Kuqe.

Kategoritë e tokës bujqësore	Lek/ha/vit 100%	Taksa në lek/ha/vit (me një zbritje prej 30%)
I	4200	2940
II	3500	2450
III	2800	1960
IV	2300	1610
V	1900	1330
VI	1600	1120
VII-X	1400	980

- Përgjegjësitë e Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore

Njësia e vetëqeverisjes vendore është autoriteti përgjegjës për administrimin e taksës mbi token bujqësore nën juridiksionin e saj, përmes ushtrimit të funksioneve të mëposhtme:

- a) mbledhjen dhe menaxhimin e informacioneve mbi tokën bujqësore për qëllime fiskale;
- b) përditësimin e të dhënave të regjistrimit qendror të bazës së të dhënave të mbi token
- c) mbledhjen me forcë të detyrimeve të taksës mbi token bujqësore;

ç) korigjimin e të dhënave në lidhje me llogaritjen e taksës, në rastet e saktësimin të informacionit për sipërfaqen e tokës bujqësore, vendndodhjen zonale, etj.;

d) shqyrtimin e ankimit administrativ të taksapaguesve.

Struktura përgjegjëse për vjeljet e taksës:

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore për të gjitha kategoritë janë të gjitha Njësitë e vetëqeverisjes vendore në rakordim me Drejtorinë e Planifikimit të të Ardhurave dhe Drejtorinë e Mjedidit pranë Bashkisë Kurbin. Ngarkohet Drejtoria e Mjedidit, konkretisht Sektori i Bujqësisë për vlerësimin e kategorisë së tokës si dhe saktësimin dhe verifikimin e periudhës së mbjelljes me kultura drufrutore dhe vreshtari për çdo fermë/fermer. Ngarkohet Sektori i Bujqësisë të saktësojë aktin e marrjes së tokës në pronësi (AMTP) sipas personave, duke pasqyruar dhe ndryshimet e herëpashershme dhe tja përcjellë këtë informacion Drejtorisë së Planifikimit të të Ardhurave Vendore për përlogaritjen dhe rakordimin e detyrimit mbi taksën e tokës bujqësore. Bashkëpunimi për mbarëvajtjen e punës për vjeljen e taksës, rregullohet me rregullore (urdhër) të veçantë të miratuar nga Kryetaria e Bashkisë.

Mënyra e pagesës:

Detyrimi për taksën mbi tokën bujqësore **është vjetor**. Për të gjitha kategoritë ky detyrim **paguhet me një këst**. Afati i fundit i pagesës është data 31 Dhjetor i vitit fiskal.

Për pronat e njohura nga Komisioni i Kthimit të Pronave , sqarojmë se për personat që i zotërojnë këto prona aplikohet taksa sipas natyrës së pronës, nëse është tokë bujqësore trajtohen si të tilla, nëse janë pyje ose inproduktive, trajtohen sipas ligjeve në fuqi.

Përfundime

Tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes, përjashtohen nga taksa per periudhën në fjalë.

I.2.3 Taksa mbi truallin

“Truall”, është një sipërfaqe toke (jo bujqesore) që ndodhet brenda vijave kufizuese të ndërtimit, përcaktuar nëpërmjet dokumentave ligjore të planifikimit, e miratuar për të ndërtuar mbi të.

Baza e taksës është sipërfaqja në m², në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit përcaktohet mbi bazën e dokumentave që e vërtetojnë atë. Taksa mbi truallin nuk do të aplikohet për kategorinë familjarë, në ato ndërtesa banimi të cilat bëjnë pjesë në kategorinë pallate banimi.

Në mungesë të dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli, *deklarata ka vlefshmëri 1 (një) vjeçare*. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, ka detyrimin të verifikojë në terren me grupet e punës së kontrollit të terrenit, saktësinë e vetë deklaramit të subjektit, jo më vonë se 10 ditë pas deklaramit. Në rast se konstatohet deklarim jo i saktë i sipërfaqes së truallit në përdorim nga ana e subjektit, atëherë do të zbatohen procedurat e ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar pikërisht neni 116.

Niveli i taksës përcaktohet në lekë për metër katror. Detyrimi llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.

Niveli i taksës mbi truallin paraqitet si më poshtë:

Të gjitha Njësitë Administrative

Klasifikimi sipas përdorimit	Vlera minimale e taksës në lekë/m²/vit me ligj	Vlera e propozuar e taksës në lekë/m²/vit
Truall për biznes	18	20
Truall për banim	0.42	0.50

Mënyra e pagesës: Detyrimi për taksën mbi truallin është vjetor. Për të gjitha kategoritë ky detyrim paguhet edhe me një këst.

Afati i pagesës është data 30 Shtator. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 30 Shtator është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Afati i shlyerjes së pagesës për detyrimin e taksës dhe tarifave familjare është data 31 dhjetor.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës:

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi truallin për të gjitha kategoritë e biznesit, është Drejtoria e Planifikimit të Ardhurave Vendore në Bashkinë Kurbin.

Detyrimi për biznesin llogaritet nga Drejtoria e Planifikimit të Ardhurave Vendore dhe shlyhet pranë çdo banke të nivelit të dytë, Postën Shqiptare sh.a, ose në arkën e Bashkisë brenda afatit të përcaktuar për vitin fiskal.

Deri në paraqitjen e dokumentacionit të pronësisë ose vetëdeklarimit të sipërfaqes së truallit, detyrimi vjetor referues i sipërfaqes së truallit për bizneset llogaritet në bazë të sipërfaqes së ndërtesës së aktivitetit fitimprurës.

Vërtetimi i pronësisë për efekt të detyrimit për pagimin e taksave

Për efekt të detyrimit për pagimin e taksave të taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë njohin dokumentet e vërtetimit të pronësisë, sipas regjistrimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme sot ASHK. Nëse prona nuk është e regjistruar në regjistrin e pasurisë së paluajtshme, për efekt të detyrimit për pagimin e taksës nga taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë, për vërtetim pronësie njohin vërtetimin e pronësisë, vendimet e komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronës, vendimet e privatizimit ose dokumentet (deklaratë nga vetë individit) e tjera, të lëshuara nga organet përkatëse shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës.

Pas deklarimit të bërë nga ana e subjektit, Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave vendore , ka detyrimin të verifikojë në terren me grupet e punës saktësimin e vetë-deklarimit të subjektit, jo më vonë se 10 ditë pas deklarimit. Në raste të komstatimit të mosdeklarimit të saktë të sipërfaqes së truallit në përdorim nga ana e subjektit , atëherë do të zbatohen procedurat e Ligjit Nr.9920 Datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë , i ndryshuar”, neni 116.

I.3 Taksa e fjetjes në hotel

Baza e taksës së fjetjes në hotel, është çmimi i fjetjes, për net fjetje në hotel. Janë subjekt i taksës të gjithë hotelet, motelet, stabilimentet turistik, pensionet, shtëpitë e pritjes, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë ushtrim veprimtarie.

Niveli i taksës së fjetjes në hotel paraqitet si më poshtë:

Niveli i taksës: Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës për tu miratuar nga Këshilli Bashkiak, për net qëndrimi me nurin e netëve të qëndrimit në hotel. Kjo taksë bazohet në ligjin nr.9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar ku pasqyrohet në tabelën e mëposhtme.

Taksa e fjetjes në hotel	Vlera minimale e taksës në lek/natë qëndrimi	Vlera e propozuar e taksës në lek/natë
Hotel 4-5 yje	105	110
Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese	35	37

Mënyra e pagesës:

Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të Bashkisë dhe evidentohet në faturën e hotelit ku shënohet çmimi dhe vlera e taksës. Kjo pagesë duhet të jetë e barsvlershme me të dhënat e mbajtura në “Regjistrin e Fjetjes” në hotel, të cilat paraqiten për konfirmim tek Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave Vendore, sa herë që i kërkohet nga kjo drejtori.

Afati i pagesës: Pagesa kryhet brenda datës 5 të muajit pasardhës.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës së fjetjes në hotel

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës është Drejtoria e Planifikimit të Ardhurave Vendore në Bashkinë Kurbin.

I.4 Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja .

Niveli i taksës : sipas kategorive dhe nënkategorive për taksën e ndikimit në infrastrukturë, është si më poshtë:

- Taksa për ndërtimet që destinohen për përdorim në **sektorin e turizmit, të industrisë, të bujqësisë të ndërtimeve individuale për qëllime përdorimi vetiak nga individët (shërbim)** të ndërtuara nga vetë individi apo sipërmarrësi për nevoja vetjake (jo për qëllime shitje) në total të jetë vlera më e lartë mes **3%** e koston mesatare të ndërtimit dhe **3%** e vlerës së preventivit.
- Taksa për ndërtimet që destinohen **për përdorim banimi, të ndërtuara nga vetë individi apo sipërmarrësi për nevoja vetjake** (jo për qëllime shitje) në total të jetë vlera më e lartë mes **1.5%** e koston mesatare të ndërtimit dhe **1.5%** e vlerës së preventivit.
- Taksa për ndërtimet që destinohen **për përdorim banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi**, të cilat kryhen nga shoqëritë e ndërtimit të jetë **4%** e vlerës së shitjes sipas çmimit të shitjes për m².
- Taksa për **rikonstruksione me karakter thelbësor** të objekteve për të cilat kërkohet leje ndërtimi të jetë **3%** e vlerës së preventivit.
- Taksa për punime të kryera me **Deklaratë Parapvake Punimesh** të jetë **2%** e vlerës së preventivit.
- Taksa për objekte të tjera si, **podrume, papafingo, pishina, platforma, struktura të ndryshme të tjera, përveç godinave dhe strukturave të tjera të mirëfillta në funksion të banimit, biznesit, turizmit, bujqësië, blegtorisë, industrisë**, të jetë vlera më e lartë mes **2%** e vlerës së investimit, dhe **2 %** e vlerës së preventivit.
- Taksa për **projekte infrastrukturore** të jetë vlera më e lartë mes **0.1 %** e vlerës së investimit, dhe **vlera e dëmeve** që mund të shkaktohen gjatë punimeve.

- Për vetëdeklarimet e ndërtimeve informale (**ALUIZNI**) taksa e ndikimit në infrastrukturë të jetë **0.5 %** e vlerës së investimit.

Mënyra e pagesës: Detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë e shlyen investitori. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet, për çdo rast, për llogari të bashkisë, që mbulon territorin ku do të bëhet investimi.

Përfundime:

- Përfundohen nga pagesa e kësaj takse investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese “Hotel/Resort me pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”.
- Përfundohen nga pagesa e kësaj takse edhe investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si “agroturizëm”, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.
- Përfundohen nga pagesa e kësaj takse investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile. Kushtet, rregullat dhe dokumentet që shoqërojnë kërkesën për përfundimin nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas kësaj pike, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
- Në rastet kur investitor ndërtimi është Bashkia, kjo taksë nuk aplikohet.

Struktura përgjegjëse për vjeljet e taksës

Struktura e ngarkuar për llogaritjen e pagesës së taksës është Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit të të Ardhurave.

I.5 Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.

Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme aplikohet për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të të drejtës së pronësisë mbi to.

Mënyra e pagesës:

Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës i transferohet. Niveli i taksës caktohet në lek/m² të bazës së taksës. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Nivelet e taksës së kalimit të pronësisë mbi ndërtesat

Kategoritë	Lekë/m ²
I. Ndërtesa banimi	100
II. Ndërtesat e tjera për tregti dhe shërbime	300
III. Ndërtesa tjera	200

Përjashtimet

Neni 29 i ligjit 9632 datë 30.10.2006, i ndyshuar jepen të gjitha rastet e përjashtimit nga pagesa e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme.

Struktura përgjegjëse për vjeljet e taksës

Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme e cila në rolin e agentit të taksës përfiton 3% të shumës së arkëtuar, diferenca kalon për llogari të buxhetit vendor jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit të Ardhurave Vendore në Bashkinë Kurbin të bëjë rakordimet me ish-Z.R.P.P Kurbin (ASHK).

I.6 Taksa e tabelës

Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet që duhet të vendosin emërtimin e subjektit në pamjen ballore të njësisë ku zhvillojnë veprimtarinë, në hapësira të tjera publike të lejuara ose private, qofshin këto të lëvizshme ose të palëvizshme dhe që shërbejnë për qëllime identifikimi.

Vendosja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulanteve. Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit harton planin për vendosjen e mundshme të tabelave për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike.

1. Taksa e tabelës zbatohet për të gjitha subjektet, të cilat vendosin tabela, të lëvizshme apo të palëvizshme, për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo dhe për të tretë, që vendosen në pamjen ballore të vendndodhjes së veprimtarisë, ose brenda territorit të përbashkët në qendrat tregtare, ose në hapësira jashtë vendndodhjes së veprimtarisë, qofshin këto publike ose private.

2. Për qëllime të zbatimit të taksës, tabelat kategorizohen në:

a) Tabelë për qëllime identifikimi të veprimtarisë së subjektit, e trupëzuar ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve. Në të tilla tabela shënohet emri ose logoja dhe/ose veprimtaria e subjektit. Në rastin e përdorimit të më shumë se një table identifikuese, vetëm njëra do të konsiderohet e tillë.

b) Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e subjektit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim. Këto tabela shërbejnë vetëm si tabela orientuese dhe vendosen jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti, për orientimin e klientelës apo të publikut drejt vendndodhjes së veprimtarisë së subjektit.

c) Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme ose e palëvizshme, e vendosur në pamje ballore ose joballore në vendin ku zhvillohet veprimtaria e subjektit, ose në hapësira të përbashkëta në qendrat tregtare, ose në hapësira të tjera publike apo private, si: tarraca, lozha, ballkone, fasada, trotuare, shtylla, mbajtëse ajrore mbi pjesë të rrugëve qytetase apo kombëtare etj., që kanë përmbajtje reklamimi

për vete apo të tretët dhe që shërben si reklamë për të njoftuar, për të tërhequr vëmendjen ose për të joshur blerësit.

ç) Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.

3. Taksa e tabelës është taksë vjetore. Bën përjashtim rasti kur tabela vendoset në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj., për të cilat taksa llogaritet dhe paguhet vetëm për periudhën kohore të lejes së dhënë nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

4. Tabela përmban shkronja, logo, simbole apo figura, që mundësojnë identifikimin e veprimtarisë së taksapaguesit apo që shërbejnë për qëllim orientimi, reklamimi ose ekspozimi. Si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja në metër katror që zë tabela në të gjithë shtrirjen e saj. Në rastin kur tabela përbëhet vetëm nga shkronja të veçuara, simbole, logo apo figura të vendosura, të gdhendura apo të pikturuara mbi një sipërfaqe ekzistuese, si: mur, fasadë e jashtme e çdo lloji, shtyllë, kolonë, apo të ngjashme me to, dhe jo nga një sipërfaqe e vetme e shtrirë e shkruar, e stampuar apo e pikturuar brenda saj, e cila vendoset mbi një sipërfaqe ekzistuese, si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja që zënë të gjitha shkronjat, figurat, logot dhe simbolet që formojnë tabelën. Kur në sipërfaqen e tabelës identifikuese përfshihen edhe shkronja, simbole dhe figura për qëllime reklamimi të një apo më shumë produkteve apo shërbimeve që furnizohen nga vetë njësia, ku është vendosur tabela, kjo tabelë vlerësohet si tabelë identifikuese dhe taksa llogaritet për këtë kategori tabelle. Në rast të kundërt, tabela vlerësohet si tabelë reklamimi dhe taksa llogaritet për tabelën për qëllime reklamimi. Në rast të përdorimit nga taksapaguesi të më shumë se një tabelle identifikuese, përveç atyre orientuese, vlerësohet si tabelë identifikuese vetëm ajo tabelë që është e trupëzuar ose jo në njësinë apo brenda territorit ku ushtrohet veprimtaria e taksapaguesit, ose që ndodhet më pranë njësisë, ose vetëm një nga tabelat, kur ka më shumë se një të tillë në njësinë apo territorin ku ushtrohet veprimtaria e tij. Çdo tabelë tjetër e tillë konsiderohet si tabelë për qëllime reklamimi dhe taksa llogaritet dhe paguhet për këtë kategori tabelle.

Taksa e tabelës për llogaritjet si më poshtë:

Taksa e tabelës për qëllim identifikimi të trupëzuar ose jo, brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë të tretëve (ku shënohet emri dhe/ose aktiviteti i biznesit) deri **në 2 m² nuk taksohet.**

Taksa e tabelës për qëllim identifikimi të trupëzuar ose jo, brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë të tretëve (ku shënohet emri dhe/ose aktiviteti i biznesit) **mbi 2 m² taksohet.**

Detyrimi dhe këstet e pagesës: Detyrimi për Taksën e Tabelës për Kategorinë 1, 2 dhe 3 është vjetor.

- Për subjektet ekzistuese detyrimi paguhet brenda datës 30 shtator të vitit fiskal. Për subjektet që duan të identifikohen me tabelë të re pas datës 30 shtator, detyrimi llogaritet dhe paguhet menjëherë për periudhën nga deklarimi.

- Për subjektet e reja detyrimi tatimor do të llogaritet që nga muaji korrent që subjekti regjistrohet pranë QKB dhe paguhet menjëherë. Taksa e tabelës për qëllime identifikimi paguhet për çdo njësi ku subjekti zhvillon aktivitetin nga muaji korrent që regjistrohet pranë QKB.

- Për subjektet ekzistuese detyrimi paguhet brenda datës 30 qershor të vitit fiskal. Për subjektet e reja detyrimi llogaritet dhe paguhet menjëherë sipas periudhës së përcaktuar në kontratën e nënshkruar me strukturat përkatëse të Bashkisë Kurbin.

- Për “kategorinë 4” detyrimi llogaritet sipas ditëve të përcaktuara në lejen përkatëse të lëshuar nga strukturat përkatëse të Bashkisë Kurbin dhe paguhet menjëherë.

Strukturat përgjegjëse për dhënien e lejeve te vendosjes dhe vjeljes te taksës së tabelës janë:

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Kurbin. Për Kategorinë Tabelë për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike: Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit bën shqyrtimin e kërkesës nga ana e subjektit, si dhe hartimin e dokumentacionit të plotë të marrjes së lejes për vendosjen e reklamave dhe përcaktimin e sipërfaqeve objekt taksimi. Kjo Drejtori njofton në mënyrë periodike Drejtorinë e të Ardhurave në lidhje me të gjitha ndryshimet në sipërfaqe (shtesa apo pakësime) që janë objekt i kësaj takse. Për të gjitha kategoritë, Drejtoria Juridike ngarkohet për përgatitjen e kontratës.

Aneksi 7

TAKSA E TABELËS SIPAS KATEGORIVE TË BASHKIVE

Nr	LLOJET E TABELAVE	Nj/matëse	Bashki Kat.I	Bashki Kat.II	Bashki Kat.III
I.	Taksë tabelle për qëllime identifikimi, të trupëzuara ose jo, brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe/ose aktiviteti i biznesit)				
a	<i>deri në 2 m²</i>	lekë/m ² /vit	0	0	0
b	<i>-mbi 2 m² deri 10 m²</i>				
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	15 000	10 000	7 000
	-me ndriçim të thjeshtë	lekë/m ² /vit	20 000	15 000	11 500
	-elektronike	lekë/m ² /vit	35 000	20 000	15 000
c	<i>mbi 10 m² deri 20 m²</i>				
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	12 750	8 500	5 950
	-me ndriçim të thjeshtë	lekë/m ² /vit	17 000	12 750	9 775
	-elektronike	lekë/m ² /vit	29 750	17 000	12 750
ç	<i>mbi 20 m² deri 40 m²</i>				
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	8 250	5 500	3 850
	-me ndriçim të thjeshtë	lekë/m ² /vit	11 000	8 250	6 325
	-elektronike	lekë/m ² /vit	19 250	11 000	8 250
d	<i>mbi 40 m²</i>				
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	6 000	4 000	2 800
	-me ndriçim të thjeshtë	lekë/m ² /vit	8 000	6 000	4 600
	-elektronike	lekë/m ² /vit	14 000	8 000	6 000
II.	Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim				
	-Tabela identifikuese	lekë/m ² /vit	120	120	120
III.	Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme e palëvizshme deri në tavanin maksimal 35 m²		Bashkia Tiranë	Bashkia Durrës dhe gjithë bashkitë e tjera të Kat.II	Bashkitë e Kat.III
	-e thjeshtë (me/pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	45 000	22 500	13 500
	-Elektronike	lekë/m ² /vit	90 000	45 000	27 000
IV.	Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.				
	-të të gjitha llojeve dhe përmasave	lekë/m ² /ditë	1 000	1 000	1 000

Shënim: Bashkitë sipas kategorive ndahen:

Kategoria I: Tiranë, Durrës

Kategoria II: Shkodër, Elbasan, Fier, Vlorë, Berat, Korçë, Pogradec, Sarandë, Lushnjë, Gjirokastrë, Lezhë, Krujë.

Kategoria III: Të gjithë bashkitë e tjera

Në llogaritjen e taksës për tabelat më të mëdha se 10 m², shumës së taksës së llogaritur për sipërfaqen deri 10 m² do t'i shtohet, shumën e taksës së llogaritur për diferencën e sipërfaqes së mbi 10 m² të shumëzuar me tarifën përkatëse të taksës. P.sh., një tabelë të thjeshtë 15 m², shumën e taksës vetore do të llogaritet: (10 m² x 15 000 lekë) + (5 m² x 12 750 lekë) = 150 000 + 63 750 = 213 750 lekë në vit (ose 17 812 lekë/muaj). E njëjta llogjikë llogaritje do të jetë edhe për sipërfaqet e tabelave mbi 20 m² dhe mbi 40 m².

Për subjektet taksapaguese që vendosin më shumë se një tabelë identifikuese, vetëm njëra nga dy tabelat identifikuese do të konsiderohet si e tillë, kurse tabela tjetër do të konsiderohet si reklamë.

Çdo tabelë reklamimi që kalon sipërfaqen 35 m², do të konsiderohet sikur është 35 m² dhe shumën e taksës llogaritet dhe paguhet vetëm për këtë sipërfaqe, pavarësisht madhësisë së saj në m².

Në kategorinë e reklamës kuptojmë çdo publicitet, formë promovimi që shërben për të njoftuar, tërhequr vëmendjen ose joshur blerësit, të vendosur në pamje jo ballore, në tarraca, lozhë, ballkone, në pjesë të rrugës, shtylla etj që kanë përmbajtje me qëllime reklamimi për vete ose të tretë.

Kapitulli II. TARIFAT VENDORE- Njesia Administrative Lac

